

**GREEN COAST SH.P.K.**

**RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI**

**L41329038D**

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, më 23.08.2023, në orën 14.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ( këtu e në vijim referuar si "Ortaku i Vetëm"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

**I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

\*\*\*\*\*

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 3.464.943.328,00 LEK (tre miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e kater milion e nëntëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e njëzetë e tete lekë).

Me qëllim zhvillimin e projekteve Vila Elite ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë. Është vlerësuar i përshtatshme zmadhimi i kapitalit me shumën 600,000 Euro (gjashtëqind mijë euro) vlere e cila e llogarituar në kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e kësaj mbledhje (1 Euro – 107.63 leke) që perben një vlere zmadhimi kapitali në vlen në Leke prej 64,578,000 ( Gjashtëdhjetë e kater milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tete mijë Lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

**VENDOS:**

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 64,578,000 LEK ( Gjashtëdhjetë e kater milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tete mijë Lekë), vlerë e cila do të investohen përkatësisht për projektin Vila Elite**
- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.**



- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 3.464.943.328,00 LEK (tre miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e katë milion e nëntëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e njëzetë e tete lekë) do të bëhet 3.529.521.328,00 ( tre miliard e pesëqind e njëzetë e nëntë milion e pesëqind e njëzet e nje mijë e treqind e njëzetë e tetë Lekë) .

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË  
GREEN COAST SH.P.K.**

**KRYETARI**



**Znj. Edlira MUKA**



**SEKRETARI**



**Z. Bers Hado**

